



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Në ankesën e

AC-I-22-0604-A0001

Paditësi/Ankuesi

M K nga fshati M, Prishtinë, përfaqësuar nga avokati B I nga Prishtina.

Kundër

E paditura

NSH "IMN Kosova" (në likuidim), përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Bajram Miftari, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-1136 të datës 12 tetor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 mars 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë i DHPGJS-së, C-IV-14-1136 i datës 12 tetor 2022 dhe Vendimi i Autoritetit të Likuidimit, PRN-029-0064 i datës 25 maj 2015.**
- 3. Obligohet e paditura që në emër të pagave të pa paguara nga data 25 janar 2008 e deri me 10 janar 2011, ti paguaj paditësit**

shumën prej 3,060.00 euro, interesin ligjor prej 10% të shumës themelore, prej 306.00 euro si dhe shpenzimet e përfaqësimit nga ana e avokatit prej 208 euro dhe për taksë 21.00 euro, të cilat do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me 19 qershor 2015, paditësi e ka dorëzuar në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit, PRN029-0064 të datës 25 maj 2015, me të cilin Autoriteti i Likuidimit, kishte refuzuar kërkesën e paditësit për kompensim e pagave të pa paguara për periudhën 07 qershor 2007 e deri me 10 janar 2011, në shumë prej 3.655,00 euro, me arsyetimin se kërkesa për paga është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Autoriteti i Likuidimit po ashtu kishte konstatuar se paditësi me datë 25 janar 2011, e ka dorëzuar një Propozim për ekzekutim E.88/2011, në Gjykatën Komunale në Prishtinë, mirëpo ky propozim nuk është aprovuar pasi që nuk ishte i bazuar në një vendim të Gjykatës të formës së prerë, andaj nuk është caktuar ndonjë detyrim për ndërmarrjen lidhur me kompensimin e pagave. Paditësi në ankesë ka pohuar se këto gjetje faktike dhe konstatime të Autoritetit të Likuidimit janë të gabuara, pasi që nuk mund të bëhet fjalë për parashkrim të kërkesës lidhur me këto paga. Ai pohon se pas fillimit të procedurës së likuidimit është paraqit një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit që të kompensohen këto paga, por e cila pa ndonjë bazë është refuzuar. Bashkë me ankesë paditësi ka dorëzuar librezën e punës, një kopje të Propozimit për përmbarrim që ishte dorëzuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë me datë 25 janar 2011, bazuar në dokumentacionin autentik të NSH-së "IMN Kosova", regjistrin e punëtorëve që e kishin parashtruar këtë propozim, vendimin për Likuidim dhe vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, autorizimin për përfaqësim, si dhe kopjen e letërnjoftimit.

Më 15 shtator 2017, AKP-ja ka parashtruar mbrojtjen ndaj padisë së parashtruar nga paditësi me të cilën ka theksuar se NSH I.M.N Kosova (në likuidim), ka hyrë në procedurë të likuidimit më 23 qershor 2014, ndërsa më

08 korrik 2014, paditësi parashtuar një kërkesë, me të cilën ka kërkuar kompensimin e shumës prej 3,655.00 euro, në emër të kompensimit të pagave të pa paguara për periudhën kohore nga data 07 qershor 2007 deri më datën 11 janar 2011. Autoriteti i Likuidimit e ka shqyrtuar kërkesën e parashtuar dhe me vendimin me numër PRN029-0064, të datës 25 maj 2015, kërkesën e parashtuar e ka refuzuar në tersi si të pa bazuar. Vendimin e vet Autoriteti i likuidimit e ka bazuar në nenin 36.2.1, të Ligjit me numër 04/L034, dhe nenit 608 të LPB-së. Në mbrojtje në ankesë AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Me 03 tetor 2017, paditësi e ka dorëzuar në DHPGJS një parashtesë dhe përgjigjet në mbrojtjen në ankesë të AKP-së. Në këtë parashtesë paditësi e kundërshton pohimin e AKP-së se kërkesa për paga është parashkruar, ndërsa në këtë parashtesë i përsëritë pretendimet e veta të cekura në ankesë.

Me 17 tetor 2017, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS kundërpërgjigjen, në të cilën ajo i kundërshton pretendimet e paditësit si të pa bazuara në ligj, dhe i përsëritë pretendimet e veta të cekura në mbrojtje në ankesë.

Me 12 tetor 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, ka marrë Aktgjykimin C-IV-15-1136, e refuzon ankesën e paditësit si të pa bazuar dhe e vërteton Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se kërkesa e paditësit për pagesën e pagave që i referohet periudhës 07 qershor 2007 e deri me datë 10 janar 2011, në shumë prej 3.655,00 euro, është tërësisht e parashkruar, pasi që Propozimi për përmbarim i paraqitur në Gjykatën Komunale në Prishtinë me datë 25 janar 2011, për të cilën paditësi nuk ka dëshmuar se si ka përfunduar procedura, nuk e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës për paga për periudhën e cekur. Shkalla e I-rë konsideron se paditësi e kishte barrën e provës për të dëshmuar se çfarë ka ndodhur lidhur me Propozimin për përmbarim. Fakti se paditësi nuk ka shpjeguar se çfarë ka ndodhur me Propozimin për përmbarim dhesë gjykata vjenë në përfundim se kjo dëshmi nuk e ka ndërprerë rrjedhën e parashkrimit të kërkesës. Lidhur me parashkrimin Shkalla e I-rë i është referuar nenin 376

paragrafi 1 të LMD-së (1978). Andaj nga këto arsye ankesa është refuzuar si e pa bazuar dhe është vërtetuar vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit.

Me 28 tetor 2023, për mes postës paditësi e dorëzon në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS C-IV-15-1136 të datës 12 tetor 2022, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave të së drejtës materiale, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e tij si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, dhe të aprovohet padia e paditësit si e bazuar. Për me tepër në ankesë paditësi ka pohuar se gjykata e shkallës së I-rë refuzimin e ankesës me arsyetimin se përfshinë edhe argumente juridike në dobi të Vendimit të Autoritetit të Likuidimit, të cilat argumente nuk përmendën fare në këtë vendim. Ai pohon se objekt i shqyrtimit nga shkalla e I-rë do të duhej të ishte vetëm përmbajtja e Vendimit të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Tutje paditësi pohon se nga provat mbështetëse të paraqitura në gjykatë, tregohet qartë se në këtë rast nuk mund të aplikohet instituti i parashkrimit. Tutje në ankesë paditësi pohon se pagat nuk janë parashkruar, pasi që me 25 janar 2011, është dorëzuar në gjykatë Propozimi për përmbarim E88/2011. Në ankesë paditësi i referohet edhe disa rasteve nga jurisprudenca e Kolegjit të Apelit, që kanë të bëjnë me punëtorët tjerë të kësaj NSH-je. Ka kërkuar kamatën, shpenzimet e përfaqësimit dhe shpenzimet për pagesën e taksës gjyqësore.

Me 20 dhjetor 2023, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditësit si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja po ashtu ka pohuar se kërkesa e paditësit është parashkruar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet ndryshohet dhe të aprovohet padia si e bazuar.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit e datës 08 korrik 2014, për kompensimin e pagave të pa paguara nga NSH "IMN Kosova" për periudhën 07 qershor 2007 e deri 10 janar 2011, në shumë prej 3.655,00 euro, ishte refuzuar nga ana e Autoriteti i Likuidimit me arsyetimin se kjo kërkesë është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit nuk i mbështet si të saktë konstatimet e Autoritetit të Likuidimit dhe të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, se kërkesa për pagat e kërkuara tërësisht është parashkruar, apo konstatimi se nuk ka ndodhë parashkrimi i kërkesës.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me ankesën e tij të dorëzuar në Shkallën e I-rë e kishte bashkangjitur një Propozim për përmbarim në bazë të dokumentacionit autentik të debitorit NSH "IMN Kosova" në Prishtinë, i cili ishte dorëzuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë me datë 25 janar 2011. Duke u bazuar në këtë provë, të cilën e ka pas parasysh edhe Shkalla e I-rë edhe Autoriteti i Likuidimit, Kolegji i Apelit konstaton se kërkesa për kompensimin e këtyre pagave nuk është parashkruar për tërë periudhën, sidomos për pjesën e periudhës nga data 25 janar 2008 deri në 10 janar 2011. Pagat e kësaj periudhe kohore nuk mund të konsiderohen si të parashkruara, pasi që paditësi ka marrë veprime ligjore, e ka paraqitur Propozimin për Përmbarim në bazë të

dokumentacionit autentik brenda 3 viteve. Nuk është relevant në këtë rast rezultati i dhënë negativ për paditësin nga Gjykata Komunale në Prishtinë lidhur me Propozimin për Përmbarim që e kishte paraqitur ai, sipas të cilës bazë po ashtu Autoriteti i Likuidimit e mbështet refuzimin e kërkesës.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me padi ka dorëzuar Librezën e punës e mbyllur me 23 qershor 2014, sipas të cilave prova vërtetohet se paditësi ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me 23 qershor 2014, kur NSH ka shkuar në likuidim.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në bazë të propozimit për përmbarim dhe me padi ka pohuar se paga mujore e tij për periudhën 07 qershor 2007 e deri 10 janar 2011, ka qenë 85 euro, dhe kjo gjë as nuk është kontestuar me mbrojtjen në ankesë të AKP-së.

Kolegji i Apelit vëren se në baze të dëshmive të ofruar nga paditësi, Shkalla e I-re e DHPGJS-së nuk kishte bazë ligjore ta refuzoj ankesën dhe ta vërtetoj Vendimin e ankimuar të Autoritetit të likuidimit, për shkak të parashkrimit të kërkesës. Paditësit pagat e papaguara nga NSH-ja për periudhën që ende nuk ishte parashkruar, përkatësisht për periudhën nga muaji 25 janar 2008 e deri në 10 janar 2011, duhet ti njihen për 36 muaj nga 85 euro, ose në shumën prej 3,060.00 euro, e cila duhet të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me Ligj në procedurën e Likuidimit.

Në bazë të nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, paditësit i njihet e drejta në interesin ligjor prej 10%, në shumën prej 306.00 euro, ndërsa në bazë të nenit 62.2 të LDHP-së paditësit duhet ti njihet e drejta e kompensimit të shpenzimeve të përfaqësimit nga ana e avokatit në shumë prej 208 euro, si dhe 21.00 euro takse gjyqësore të cilat shuma duhet të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me Ligj në procedurën e Likuidimit.

Prandaj nga këto arsye, aprovohet ankesa e paditësit si bazuar, dhe ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së I-rë si dhe Vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit, pasi që nuk janë të bazuara në ligj.

Nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Pasi që ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore më 08 nëntor 2022 në shumë prej 20 euro, për procedurën ankimore para Kolegjit të Apelit, nuk caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 14 mars 2024.

Mr.Sc Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
